



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

MEMORANDUM SHPJEGUES

**PËR DRAFT RREGULLOREN PËR KLASIFIKIMIN E
VENDEVE TË PUNËS PËR NËPUNËSIT CIVIL NË
ADMINISTRATËN E SISTEMIT GJYQËSORE**

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Draft Rregullorja për Klasifikimin e Vendeve të Punës për nëpunësit civil në administratën e sistemit gjyqësor, synon të përcaktojë kategoritë dhe klasat e nëpunësve civil të administratës në sistemin gjyqësorë, përfshirë emërtesat e pozitive për çdo klasë, grupin, koeficientin, përshkrimin e përgjithshëm për secilën kategori, klasë, procedurën dhe metodologjinë e klasifikimit të pozitivave të punës.

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë nëpunësit civil të punësuar në administratën e sistemit gjyqësor.

Draft rregullorja përcakton procedurat e përshkrimit të përgjithshëm të vendeve të punës për secilën kategori të nëpunësve në administratën e sistemit

	<p>gjqësor, duke i përfshirë detyrat dhe përgjegjësit kryesore për secilën kategori.</p> <p>Draft rregullorja bënë një klasifikim të faktorëve që janë të rëndësishëm për kategorizimin e klasave duke filluar nga rëndësia, liria në vendimmarje e deri tek vështirësia e ushtrimit të punës.</p> <p>Ky draft parasheh krijimin e grupit për vlerësimin e klasifikimit, grup ky i cili ndihmon në përshkrimin e vendeve të punës dhe i cili harton propozimin për klasifikimin e pozitive çdo herë që përgatitet një rregullore për organizimin e brendshëm të institucionit.</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Hartimi i Draft Rregullores për klasifikimin e vendeve të punës për nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, është paraparë e nevojshme për shkak të ndryshimeve ligjore, përkatësisht pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe Ligjin për pagat në Sektorin Publik, sipas së cilit kërkohet një rregullim i veçantë për procedurën e klasifikimit të vendeve të punës në administratën e sistemit gjyqësor.</p> <p>Ligji, personelin në administratën e sistemit gjyqësor e kategorizon në nëpunës civil me status të veçantë, duke dhënë autorizime që procesi i klasifikimit të nëpunësve në administratën e sistemit gjyqësor, të rregullohet nga Këshilli, në përputhje me ligjin dhe aktet e veçanta të miratuar prej tij.</p>

Përmes hartimit të këtij drafti synohet të rregullohet në mënyrë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse përshkrimi i detyrave të punës dhe kategorizimi për nëpunësit në administratën e sistemit gjyqësor, pasi që deri me hyrjen në fuqi të këtij ligji, struktura e kategorizimit të nëpunësve në administratën e sistemit gjyqësor nuk ka qenë e rregulluar me një akt të veçantë.

Andaj përmes hartimit të këtij drafti synohet që të krijohet një strukturë e qartë duke përfshirë kriteret dhe standardet e përzgjedhjes për vendet e punës, duke siguruar që personeli i përzgjedhur t'i përmbushë kualifikimet dhe aftësit e nevojshme për të kryer detyrat e tyre me efikasitet.

Hartimi i kësaj rregullore është i rëndësishme për disa arsye:

Së pari, draft rregullorja ka për qëllim themelimin e një sistemi të strukturuar dhe transparent të klasifikimit të vendeve të punës, duke siguruar që sistemi i administratës gjyqësore të funksionojë në mënyrë efikase.

Së dyti, nxjerrja e këtij akti përbën akt unifikues për administratën e sistemit gjyqësor, pasi që me këtë akt në mënyrë të përgjithshme bëhet përshkrimi i detyrave dhe klasifikimi i vendeve të punës për nëpunësit e administratës. Ku një rregullim i tillë e bënë të mundshme që ky klasifikim të menaxhohet më mirë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, duke siguruar një përshtatje të mirë në mes të detyrave dhe kompetencave të nëpunësve.

	<p>Gjithashtu, një administratë gjyqësore e strukturuar dhe organizuar mirë, sipas një rregullore të qartë, rrit besimin e publikut në drejtësi dhe integritetin e institucioneve të drejtësisë.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të Rregullores për klasifikimin e vendeve të punës për nëpunësit civil në administratën e sistemit gjyqësor.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 26 prill 2024.</p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft të rregullores përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net</p>